

CIG

**COUNCIL FOR
INCLUSIVE
GOVERNANCE**

SERBËT E KOSOVËS DHE BEOGRADI: NDRYSHIMI I STRATEGJIVE

Raport Aktivitetesh

Dhjetor 2010

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

Nju Jork, 2010

Përmbledhje e përgjithshme

Pjesëmarrja e serbëve të Kosovës në jug te lumit Ibër në zgjedhjet parlamentare të 12 dhjetorit sinjalizon për një ndryshim të madh të strategjisë: nga bojkoti në pjesëmarrje. Politika e bojkotit, e cila ishte konsideruar si politikë e duhur si kundërpërgjigje ndaj deklaratës së pavarësisë së Kosovës, nuk konsiderohet më efikase, sepse ajo nuk i pengon institucionet e Kosovës “të marrin vendime për serbët, pa serbët”. Strategjia e re e pjesëmarrjes ballafaqohet me disa sfida: ndarjet e vazhdueshme ndërmjet serbëve të Kosovës; kundërshtimi i Beogradit dhe serbëve në veri të Kosovës ndaj pjesëmarrjes; dhe neglizhenca e shqiptarëve të Kosovës rreth implementimit të pikave të planit të Ahtisaarit që kanë të bëjnë me komunitetin serb sikurse edhe frika se pjesëmarrja vetëm e serbëve të jugut do të forcoj edhe më tej idenë e ndarjes së veriut.

Ekzistojnë ndarje ndërmjet serbëve në jug, si dhe në mes serbëve në jug dhe serbëve në veri. Ndarjet mes partive serbe në jug do të mund të tejkaloheshin duke formuar një koalicion pas-zgjedhor. Kushtetuta e Kosovës ofron përfshirje automatike të serbëve në qeveri, duke iu ndarë atyre dy ministri por nuk e specifikon nëse ato duhet të ndahen ndërmjet të gjitha partive parlamentare serbe. Bazuar në konceptin e proporcionalitetit të aplikuar në ndarjen e ulëseve të rezervuara ndërmjet partive serbe, të dyja ministritë do të duhej të ndaheshin në proporcion me votat e fituara në zgjedhje. Nëse të dy ministritë do t’i jepeshin vetëm një partie parlamentare serbe, ajo parti do të rrezikonte të konsiderohej si “partia serbe lojale ndaj shqiptarëve”, dhe kjo do të mbillte farërat e një konflikti të gjatë përbrenda komunitetit serb.

Ekziston frika legjitime se rritja e vijave ndarëse mes Beogradit dhe serbëve të Kosovës në jug do të mund të kishte pasoja negative kryesisht për serbët e Kosovës por edhe për Beogradin. Pak serbë do të mbeteshin në Kosovë po të mos ishte përkrahja e Beogradit, por nuk do të kishte fare prezencë të Serbisë në Kosovë pa serbët e Kosovës. Nëse marrëdhënia është e ndërvarur, atëherë ajo do t’u mbijetojë vijave ndarëse ekzistuese. Në të kundërtën, përkeqësimi i marrëdhënieve mes Beogradit dhe serbëve të Kosovës do të ndikonte drejtpërdrejt në mirëqenien e këtyre të fundit. Burim i mosmarrëveshjeve janë vizionet e tyre të kundërta rreth aktivitetit politik në Kosovë: pjesëmarrja përballë bojkotit. Komuniteti serb i Kosovës është i vetëdijshëm se pa përkrahjen e Beogradit ai do të ketë sukses të kufizuar në punën e tij me organet e Kosovës, kryesisht për shkak se është shumë i vogël që t’a mbaj presionin ndaj institucioneve të dominuara nga shqiptarët, e sidomos tani që ndikimi ndërkombëtar në institucionet e Kosovës po zbehet. Përkundër këtyre implikimeve, serbët në jug duken të vendosur – siç shihet nga dalja e madhe e tyre në zgjedhje – që ta braktisin politikën e bojkotit dhe ta zëvendësojnë me atë politikë të pjesëmarrjes.

Serbët e Kosovës në jug nuk janë të vetëm në këtë ndryshim të strategjisë. Edhe Beogradi po e rishikon politikën e tij rreth Kosovës. Beogradi ka bërë tri ndryshime madhore politike. Së pari, edhe pse nuk e perkrash pjesëmarrjen në zgjedhje dhe integrimin në institucione, ai më nuk sanksionon ata të cilët votojnë, kandidohen dhe i bashkohen institucioneve të Kosovës. Së dyti, Beogradi ka zvogëluar shumë e fondeve të dedikuara për serbët e Kosovës duke reduktuar ndihmën sociale dhe pagat si dhe duke mbyllur vende të caktuara pune, sikurse ato të kryetarit të komunave paralele pa popullatë substanciale serbe. Së treti, tre vite pas ndërprerjes së komunikimit me Prishtinën, Beogradi është pajtuar për dialog të drejtpërdrejt me institucionet e Kosovës, që pritet të fillojë në pranverë, nën sloganin e “bashkëpunimit pa njohje”. Tani që

Beogradi synon të angazhohet drejtpërdrejt me institucionet e Kosovës, bojkoti i po të njejtave institucione nga serbët e Kosovës është jopraktik dhe joefikas. Përkundër këtyre ndryshimeve politike, zyrtarët serbë tërheqin vërejtjen se serbët e Kosovës nuk duhet të kenë iluzione se Beogradi do ta përkrahte pjesëmarrjen e tyre në institucionet e Kosovës para arritjes së një marrëveshje të përgjithshme me Prishtinën.

Disa parti dhe politikanë shqiptarë janë poashtu kundër pjesëmarrjes së serbëve, mirëpo për arsye tjera. Ata frikësohen se integrimi vetëm i serbëve në jug – përderisa ata në veri vazhdojnë të konsolidojnë institucionet paralele – do të forconte edhe më tej idenë e ndarjes së veriut. Sikurse në qeveri ashtu edhe në opozitë, këto parti dhe politikanë kanë potencial signifikant për vonimin e implementimit të planit të Ahtisaarit, sidomos të pjesëve të lidhura me komunitetin serb, me theks të veçante në decentralizimin.

Këto përfundime kanë dalë nga një numër aktivitete – një tryezë e rumbullakët për serbët e Kosovës në Prishtinë dhe një tryezë e rumbullakët për serbët e Kosovës dhe zyrtarëve të Beogradit në Beograd, diskutime individuale me disa politikanë dhe analistë në Prishtinë dhe Beograd, e po ashtu edhe me përfaqësues ndërkombëtarë në Kosovë – të organizuara nga Këshilli për Qeverisje Përfshirëse.

Strategjia e re

Kush janë përfaqësuesit legjitim të serbëve të Kosovës ka qenë pyetja më e shpeshtë qysh nga viti 2004, kur koalicioni 22-anëtarësh “Povratak” kishte braktisur qeverinë e Kosovës dhe parlamentin 120-anëtarësh në shenjë proteste pas trazirave ndëretnike të marsit të po të njejtit vit që lanë disa të vdekur dhe me qindra serbë të zhvendosur. Serbët bojkotuan zgjedhjet më 2004 dhe 2007 dhe morën pjesë në zgjedhjet lokale të zgjedhjeve të Serbisë në vitin 2008, duke krijuar institucione të ndara lokale, të njohura si institucione “paralele”, të përkrahura nga Beogradi por të kundërshtuara nga Prishtina.

Një vit e gjysëm më vonë, në nëntor 2009, serbët në jug të lumit Ibër poashtu kanë marrë pjesë në numër solid, rreth 25 për qind, në zgjedhjet lokale të vitit 2009, duke krijuar një grup tjetër të institucioneve lokale, të përkrahura nga Prishtina por të kundërshtuara nga Beogradi. Numri i kënaqshëm i votave bëri që përfaqësuesit e këtyre institucioneve të përvetësojnë një shkallë të legjitimitetit dhe lojalitetit të serbëve, edhe pse legaliteti dhe legjitimiteti i tyre është vënë në pikëpyetje nga Beogradi dhe institucionet paralele.

Përfaqësuesit serbë në nivelin qendror, duke qenë se kishin marrë një numër tepër të vogël votash prej rreth 1 për qind, nuk mund të pretendonin të njejtin nivel të legjitimitetit. Kjo çështje ishte zgjidhur nga pjesëmarrja e serbëve në zgjedhjet e Kosovës të 12 dhjetorit. Dalja e kënaqshme e serbëve, me rreth 40 për qind, jo vetëm që i mvesh me legjitimitet të mjaftueshëm parlamentarët e zgjedhur serbë por gjithashtu e aprovon zhvendosjen në strategji, nga bojkoti në pjesëmarrje. “Rezistencës përmes bojkotit i ka kaluar koha”, thotë një bashkëbisedues. Disa thonë se ajo ka vazhduar shumë më gjatë se sa që ka qenë produktive – shumë vendime për serbët por pa serbët ishin bërë në institucionet e Kosovës gjatë kësaj kohe. Tri vite pas deklaratës së pavarësisë, numri i serbëve që mbështesin pjesëmarrjen është duke u rritur. Burimet thonë se

një pjesë e konsiderueshme e popullatës serbe në veri është poashtu në favor të pjesëmarrjes, dhe ata do kishin votuar po t'u ishte ofruar siguri e mjaftueshme.

Politikanët serbë të Kosovës presin, edhe pse heshturazi, që autoritetet e Kosovës dhe qeveria e Serbisë të mbështesin, ose së paku të mos minojnë, qasjen e re. Nga Prishtina pritet që të mbështesë këtë qasje por zëra të caktuar brenda partive politike shqiptare, të cilët i frikësohen ndarjes së veriut, e kundërshtojnë përfshirjen institucionale të serbëve të jugut përderisa serbët e veriut vazhdojnë të fuqizojnë sistemin e tyre paralel. Nga Beogradi pritet që as të mos e mbështesë e as mos ta minojë përfshirjen e serbëve të jugut në institucionet e Kosovës. Por, “në emër të interesave nacionale, dhe këtë vetëm emër”, do të mund t'i thoshte serbëve mos t'i bashkohen institucioneve, por nuk do të ndërmerre kurrfarë aksioni kundër tyre, thotë një analist.

Tre faktorë mund të shihen si kyç në ndryshimet në strategji: qasja pragmatike e serbëve të Kosovës, duke pranuar institucionet e Kosovës por jo edhe pavarësinë e saj; vendimi i Beogradit për fillimin e dialogut me autoritetet e Kosovës, duke e bërë kështu bojkotin e të njejtave nga serbët e Kosovës joefikas dhe të pakuptimtë; dhe normalizimi thelbësor i marrëdhënieve mes shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë. Përmirësimi i marrëdhënieve shqiptaro-serbe rezultoi kur shqiptarët kuptuan se serbët edhe pse e kundërshtojnë pavarësinë nuk janë kërcënim për te, si dhe kur serbët kuptuan se një status i kënaqshëm për ta do të mund të gjendej në Kosovë. Ky status mbi të gjitha do të eliminonte izolimin e tyre dhe varësinë në ndihmën sociale nga Beogradi dhe Prishtina.

Pjesa më e madhe e çështjeve të lidhura me komunitetin serb – decentralizimi, institucionet lokale, arsimit, punësimi, telekomunikimi, prona e kështu me rradhë – më së miri do të mund të adresoheshin përmes implementimit të provizioneve legale që janë pjesë e planit të Ahtisaarit dhe që garantohen nga institucionet e Kosovës. Plani i Ahtisaarit, për shembull, i obligon autoritetet e Kosovës të ofrojnë arsimin në gjuhën serbe në të gjitha nivelet dhe të formojnë brenda Radio Televizionit të Kosovës një kanal televiziv në gjuhën serbe, ku rreth 200 gazetarë dhe staf ndihmës do të mund të punësoheshin. RTK-ja, me një kanal televiziv dhe dy radiostacione, momentalisht punëson rreth 800 njerëz. Edhe pse autoritetet e Kosovës nuk i kanë përmbushur këto obligime, pak serbë janë ankuar për këtë, kryesisht për shkak se ata kanë refuzuar planin e Ahtisaarit në tërësi, duke u bazuar në atë se ky plan parashikoi pavarësi për Kosovën. Megjithatë, kohët e fundit, çështja e kanalit televiziv është rishfaqur dhe një numër i përfaqësuesve politik janë zotuar të merren me këtë pas krijimit të institucioneve.

Serbët janë të vetëdijshëm se pjesëmarrja në zgjedhje nuk është ilaç për të gjitha. Është thjesht një hap i nevojshëm por i pamjaftueshëm për të përfituar statusin e synuar. Puna më e rëndë dhe e komplikuar fillon pas zgjedhjeve. Partitë serbe kanë qenë të kujdesshme që të mos rrisin shpresat për gjërat të cilat nuk mund të arrihen vetëm duke marrë pjesë në zgjedhje. Hapat e ardhshëm janë shumë të rëndësishme dhe përfaqësuesit serbë kanë nevojë për përkrahjen e popullsisë serbe. Disa parti shqiptare të cilat haptazi kundërshtojnë decentralizimin dhe të drejtat tjera shtesë për komunitetet më të vogla poashtu mund të shkaktojnë disa vonesa në procesin e implementimit. Kjo është arsyeja pse shumë analistë sygjerorjnë që mbikqyrja ndërkombëtare e institucioneve të Kosovës është faktor vendimtar, dhe se po për këtë Beogradi dhe serbët e Kosovës do të duhej të përmirësonin marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare në Kosovë.

Implementimi i këtyre të drejtave përfundimisht varet nga besimi i aktorëve politik të Kosovës se këto të drejta nuk janë thjesht të nevojshme – vetëm për ta kënaqur komunitetin nderkombëtar – por janë edhe të drejta. Në shoqëritë a pas-konfliktit, të drejtat e komuniteteve më të vogla janë zakonisht më të pasigurta. “Por kjo është pikërisht arsyeja pse serbët duhet të angazhohen më intenzivisht në procesin politik, e jo ta bojkotojnë atë”, thotë një serb i Kosovës.

Serbët në fakt janë duke u involvuar më shumë në proces. Arsyeja për këtë nuk është për shkak se ata janë bërë më të pranueshëm ndaj pavarësisë së Kosovës por për shkak se besojnë se pjesëmarrja politik është e vetmja rrugë për mbrojtjen e komunitetit të zvogëluar serb. Edhe pse pjesëmarrja është duke fituar simpatinë e serbëve, së paku në jug, përpjekjet për të krijuar një listë të përbashkët zgjedhore dështuan. Burimet thonë se kjo ndodhi për shkak të grindjeve personale e jo për shkak të dallimeve ideologjike. Mirëpo disa përfaqësues të partive presin që këto grindje personale të tejkalohen pas zgjedhjeve. Edhe pse komuniteti serb është shumë më i vogël se ai shqiptar, e cila kishte shtatë lista zgjedhore, votuesit serbë u desh të zgjedhnin në mesin e tetë listave, ku Partia e Pavarur Liberale dhe Lista e Bashkuar Serbe ishin konkurrentët kryesorë për votën serbe. Një zyrtar pranoi se një listë e përbashkët do të kishte qenë shumë më e mirë, por shtoi se tetë lista janë më të mira se asnjë.

Por nëse grindjet personale mbizotërojnë, jo vetëm që nuk do të ketë bashkëpunim ndërmjet partive serbe por vazhdimi i konfliktit mund të dëmtojë synimet afatgjata të komunitetit serb. Sipas një bashkëbiseduesi, nëse vetëm një partie parlamentare i bëhet ftesë që t’i bashkohet qeverisë, ajo rrezikon të konsiderohet si “partia serbe lojale ndaj shqiptarëve”, ngjajshëm me “shqiptarët lojal ndaj Serbisë në vitet e 90-ta”. Një zyrtar i një partie serbe ka thënë se partia e tij, nëse hyn në parlament, do të insistojë në marrjen e fuqisë proporcionale të paraparë me pakon e Ahtisaarit dhe me kushtetutën e Kosovës, e cila, sipas tij, nuk parashikon opozitë serbe në parlamentin. Plani i Ahtisaarit dhe kushtetuta e Kosovës garantojnë përfshirjen automatike të serbëve në qeveri, duke iu ndarë atyre dy ministri, por nuk shpjegojnë nëse të gjitha partitë serbe do të duhej të ishin pjesë e qeverisë, ndoshta për shkak se kjo çështje nuk ishte parashikuar në atë kohë. Prandaj, çështja mbetet e hapur për interpretime.

Shumë përfaqësues serbë rekomandojnë që të dy ministrinë të ndahen në proporcion me numrin e votave të fituara në zgjedhje, ngjajshëm me ndarjen e dhjetë ulëseve të rezervuara parlamentare. Mirëpo të tjerët thonë se i përket partisë fituese, pra një partie shqiptare, të vendosë se cilën parti apo cilat parti serbe ti ftojë për t’iu bashkuar koalicionit qeverisës. Edhe pse partia më e madhe mund ta ketë këtë të drejtë, ajo megjithatë do të shkonte kundër frymës së provizioneve të Ahtisaarit mbi përfshirjen e komuniteteve më të vogla në trupat vendimmarrës. Nëqoftëse disa parti serbe do të përjashtoheshin, kjo do të mbillte farërat për konfrontim brenda komunitetit serb, përveç në rastet kur ato vullnetarisht do të vendosnin të mbeteshin në opozitë.

Sipas një analisti serb mundësia e arritjes së një marrëveshje brenda përbrenda serbëve nuk varet nga ajo se “kush kandidohet, por kush zgjedhet”, dhe shton se cilësia e deputetëve të zgjedhur gjithashtu do të determinonte suksesin e përfaqësimit institucional të serbëve. Kandidatët më të mirë zgjedhen në zgjedhje të lira e të drejta, por sipas disa serbëve, zgjedhjet e Kosovës ndoshta janë të lira pasi që askush nuk pengohet të votojë por ato nuk janë të drejta pasi që disa parti kanë më shumë përparësi financiare dhe qasje në burime publike sesa disa parti tjera, kur bëhet fjalë për fushata zgjedhore. Disa prej serbëve ishin të brengosur se ata të cilët kanë më shumë para,

duke iu referuar Partisë së Pavarur Liberale, do të marrin më shumë vota. Liberalët e pavarur vazhdimisht kanë mohuar këto vlerësime, duke thënë se nuk kanë qasje në burimet të cilat përmenden. Ata poashtu janë zotuar se, pas zgjedhjeve, do të bashkëpunojnë me të gjitha partitë serbe, përfshirë edhe ato të cilat nuk do t'ia dalin të hyjnë në parlament.

Serbët e Kosovës propozuan bashkëpunimin me partitë parlamentare të komuniteteve tjera shqiptare të cilave u janë rezervuar 10 ulëse. Një bashkëpunim i tillë do të rriste rolin dhe fuqinë negociuese të partive serbe, posaçërisht duke marrë parasysh faktin se asnjë parti shqiptare nuk mund të krijojë qeverinë e vetme. Dhjetë ulëset e rezervuara për serbët, së bashku me tri tjera të cilat mund t'i fitojnë të kombinuara me 10 ulëset e rezervuara të komuniteteve tjera janë me vlerë të madhe në një parlament 120-anëtarësh. Në mandatin e kaluar, partitë serbe në parlament ishin të ndara, me disa në qeveri e disa tjerë në opozitë. Këto ndarje ndikuan poashtu edhe në mënyrën se si votohej, ku ata që ishin në qeveri votonin në favor të propozimeve të qeverisë, kurse ata në opozitë votonin kundër. Për shembull, partitë serbe në qeveri votuan pro vendimit mjaft të ndjeshëm për privatizimin e Postës e Telekomunikacionit të Kosovës, e përkrahur vetëm nga partia e kryeministrit Hashim Thaçi (partitë shqiptare, përfshirë edhe partnerin e koalicionit, Lidhjen Demokratike të Kosovës, votuan kundër). Partitë opozitare serbe e konsideronin Partinë e Pavarur Liberale – e cila ishte partnere e koalicionit me dy ministri – si partnerin më lojal të Partisë Demokratike të Kosovës të Hashim Thaçit. Liberalët kanë mohuar këto akuza.

Përvojat e kaluara tregojnë se kohezioni politik i serbëve – gatishmëria e politikanëve dhe partive politike të bëjnë kompromise me njëra tjetrën dhe t'i përgjigjen thirrjeve të votuesve për veprim të përbashkët – është i vështirë të arihet dhe të mbahet. Një ish-anëtar serb i parlamentit të Kosovës, i afërt me dinamikën e brendshme të ish-koalicionit serb “Povratak”, thotë se koalicioni 22-anëtarësh për dy vite sa kishte ekzistuar, nuk kishte arritur të tejkalojë dallimet në mesin e anëtarëve të saj. Ai pret që e njëjta të përsëritet. Kushtet për një koalicion pas-zgjedhor të partive serbe tashmë janë edhe më të zbehta sesa në vitet 2002-2004. Serbët e veriut masovikisht bojkotuan zgjedhjet dhe një numër serbësh në jug ende janë lojal ndaj institucioneve paralele. Mirëpo, sipas një anëtari tjetër të parlamentit, përvojat e kaluara tregojnë se qëllimet e komunitetit serb mund të arrihen edhe ndaras.

Disa probleme, sikurse energjia elektrike, telefonat, targarat e veturave, krijimi i një kanali televiziv në gjuhën serbe me emetim në mbarë Kosovën, punësimi në ndërmarrjet publike e kështu me rradhë do të mund të zgjidheshin nga një veprim i fuqishëm i serbëve të Kosovës, qoftë ai veprim i bashkuar apo i ndarë. “Neve na duhet të organizojmë fushatë zgjedhore me linja telefonike të paqëndrueshme apo pa stacione televizive përmes të cilëve do të komunikojmë me votuesit tanë”, ka thënë një bashkëbisedues i cili ishte kandidat në zgjedhjet e fundit. Zgjidhja e këtyre problemeve nuk do të jetë e lehtë tani që institucionet e Kosovës duket se janë duke forcuar pavarësinë e tyre kurse ndikimi ndërkombëtar është duke u zbehur. Një zyrtar i lartë i ministrisë së brendshme, e cila ka filluar shpërndarjen e targarave të reja me mbishkrimin “Republika e Kosovës” në to, ka thënë se së shpejti veturave të serbëve të Kosovës të cilat kanë targa të Serbisë do t'u ndalohet qarkullimi në trafik. Ai poashtu tërhoqi vëmendjen se nëse Serbia refuzon t'i pranojë targarat e Kosovës, qeveria e tij do të mund të shqyrtojë kundërpërgjigjen, duke “anuluar njohjen” e targarave të Serbisë, veprim ky i cili do të kufizonte tejmasë lëvizjen e serbëve të Kosovës. Edhe pse dialogu i paralajmëruar mes Beogradit e Prishtinës, që pritet të fillojë në

pranverë, zyrtarisht thuhet se do të merret me çështje të tilla, serbët e Kosovës, megjithate janë skpetik rreth rezultateve eventuale. “Dialogu mund të vazhdojë pafundësisht, pa prodhuar kurrfarë rezultati, siç ka ndodhur shpesh në negociata në të kaluarën”, ka thënë një pjesëmarrës në diskutim, i afërt me negociatat e kaluara Beograd-Prishtinë.

Paralajmërimin e zyrtarit të ministrisë së punëve të brendshme rreth targave të veturave disa serbë e konsiderojnë si shenjë për fillimin e “strategjisë agresive” të qeverisë së Kosovës drejtuar kundër veprimeve të Beogradit, por e cila në rradhë të parë do t’i dëmtonte serbët e Kosovës në jug, duke marrë parasysh gjendjen e tyre specifike. “Edhe pse qëllimi i kësaj strategjie është për t’iu kundërvënë Beogradit, komuniteti serb është ai që do të vuaj, e jo Beogradi”, ka thënë një bashkëbisedues, duke shtuar se serbët mund të parandalojnë zbatimin e një politike të tillë të dëmshme vetëm nga “brenda institucioneve”. Kjo do të duhej të shërbente si provë që Beogradi ta njohë realitetin jo të favorshëm dhe të përkrahin pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Kosovës. Disa thanë se serbët në institucione do të mund të vepronin edhe si ndërmjetës joformalë në komunikimin e ardhshëm mes Beogradit e Prishtinës.

Marrëdhënie e ndërvarur

Një pjesë e madhe e serbëve frikësohen se hendeku mes Beogradit dhe serbëve të Kosovës do të mund të ketë pasoja të mëdha dhe të dëmshme kryesisht për serbët e Kosovës, por edhe për Beogradin. “Nuk do kishte serbë në Kosovë pa përkrahjen e Serbisë, por nuk do të kishte as prani serbe në Kosovë pa serbët e Kosovës”. Kështu e kishte përmbledhur një serb i Kosovës marrëdhënien e Beogradit me serbët e Kosovës. Nëse marrëdhënia e tyre është e ndërvarur, atëherë ajo do t’i tejkalojë vijat ndarëse ekzistuese. Por nëse nuk ndodh kjo, përkeqësimi i marrëdhënieve të Beogradit me serbët e Kosovës do ndikojë drejtpërdrejt në mirëqenien e këtyre të fundit. Burimi i mosmarrëveshjeve është vizioni i ndryshëm dhe gjithnjë e më i kundërt i serbëve të Kosovës dhe Beogradit në lidhje me pjesëmarrjen politike në institucionet e Kosovës.

Një numër gjithnjë më i madh i serbëve të Kosovës besojnë se standardi i tyre i jetesës – energjia elektrike dhe telefonat jostabil, siguria, punësimi e kështu me rradhë – janë më të rëndësishme se interesat nacionale të Serbisë. Ky numër gjithnjë e në rritje i votuesve serbë, përkundër thirrjeve të Beogradit për bojkot, shpesh prezantohet si evidencë për ndryshimin e pikëpamjes se serbëve të Kosovës karshi Beogradit. Edhe pse Beogradi do të mund ta zvogëlonte përkrahjen e tij për serbët e Kosovës, e posacërisht ate financiare duke ndikuar kështu në mirëqenien e tyre, shumë serbë thonë se nuk i frikësohen “hakmarrjes” nga Beogradi për shkak se marrëdhënia mes Beogradit e serbëve të Kosovës është e ndërvarur: nuk do të ketë prani serbe në Kosovë pa serbët e Kosovës, por nuk do të ketë as serbë në Kosovë pa Serbinë. “Serbët e Kosovës janë ‘tapija’ e vetme e pronësisë së Serbisë mbi Kosovën”.

Beteja e serbëve të Kosovës është e drejtuar në dy fronte: hyrja në institucionet e Kosovës për të përmirësuar prospektet e tyre politike dhe ekonomike në Kosovën me shumicë shqiptare; dhe të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të bindur Beogradin që ai t’i përshtat politikat e tij mjedisit që vazhdimisht ndryshon – një politikë dinamike përballë një politike statike. Përderisa beteja në frontin e parë do të jetë brenda institucioneve, qeverisë dhe parlamentit të Kosovës, ku shqiptarët nuk mund t’i injorojnë, beteja në frontin e dytë do të jetë më e vështirë, jo vetëm se serbët e Kosovës nuk janë nejtë të përfaqësuar në institucionet e Serbisë – së paku jo ata të cilët nuk

pajtohen me qeverinë e Serbisë – por edhe për shkak se zyrtarët serbë janë të prirur t'i anashkalojnë serbët e Kosovës. Sipas disa bashkëbiseduesve, Partia Demokratike e presidentit Tadic, e cila udhëheq ministrinë për Kosovë e Metohi, vazhdimisht ka injoruar ngjarjet në të cilat marrin pjesë serbët të cilët janë kritikë ndaj qeverisë së Serbisë.

Shumë serbë të Kosovës janë të hidhëruar në Beogradin për marrjen e vendimeve thelbësore për të ardhmen e tyre, sikurse ai për pjesëmarrjen në zgjedhje, në konferenca përmes telefonit dhe pa konsultim të mirëfilltë me ta. “Është e paskrupullt se si zyrtarët e Beogradit vendosnin për të ardhmen tonë në atë mënyrë, përderisa ne në Kosovë po i përgjëroheshim Beogradit që të flasë me ne dhe që të merreshim vesh për një zgjidhje të përbashkët”, ka thënë një serb i Kosovës. Ky vendim forcoi edhe më tej pikëpamjen se Beogradi është më shumë i interesuar në marrjen e vendimeve të cilat “i joshin votuesit në Serbi se sa vendimeve të cilat mbrojnë interesat e serbëve të Kosovës”. Disa kanë thënë se vendimet e Beogradit do të duhej të ishin këshilluese, e jo vendime autoritative rreth veprimeve që do të duhej të ndërmerreshin nga serbët e Kosovës.

Një numër i pjesëmarrësve në diskutim propozuan organizimin e disa aktiviteteve në mes anëtarëve të parlamentit të Serbisë, posaçërisht ata të cilët vijnë nga Kosova, si dhe anëtarëve serbë të parlamentit të Kosovës. Qëllimi i një iniciative të tillë do të ishte formulimi i një platforme të përbashkët për bashkëpunim mes gjithë atyre të cilët punojnë në çështjet e serbëve të Kosovës.

Komuniteti i serbëve të Kosovës është i vetëdijshëm se në mungesë të përkrahjes së plotë të Beogradit, ai do të ketë sukses të kufizuar në punën me organet e Kosovës, kryesisht për shkak se është shumë i vogël që ta ushtrojë tryshinë e nevojshme mbi institucionet e dominuara nga shqiptarët, e sidomos tani që ndikimi ndërkombëtar në këto institucione është duke u reduktuar. Edhe pse asnjëherë nuk është pajtuar me planin e Ahtisaarit, influenca e Beogradit për të fituar të drejtat e garantuara me këtë plan është thelbësore. Shumë serbë të Kosovës kanë thënë se pa përkrahjen e Beogradit, serbët e Kosovës, të cilët përbëjnë vetëm rreth 5 për qind të popullatës së Kosovës, do të ishin vetëm një nga minoritetet e shumta e të vogla në rajon. Së këndejmi, përkeqësimi i marrëdhënieve mes Beogradit dhe serbëve të Kosovës nuk do të duhej të ishte opsion. Ajo cka do të duhej të ishte në tavolinë është përmirësimi i kësaj marrëdhënieje, duke ia përshatur atë rrethanave gjithnjë në ndryshim.

Ndryshimi i politikës së Beogradit

Beogradi ka bërë tri ndërrime madhore politike karshi Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Së pari, edhe pse nuk e përkrah pjesëmarrjen në zgjedhje, Beogradi më nuk i dënon ata të cilët votojnë, kandidohen dhe i bashkohen institucioneve të Kosovës. Qeveria e Serbisë, në një takim përmes telefonit ka vendosur ta kundërshtojë pjesëmarrjen në zgjedhje për shkak se “nuk ekzistojnë kushtet që serbët të votojnë”. Por Beogradi gjithashtu ka vënë në pah se ata të cilët “devijojnë nga kjo politikë nuk do të dënohen”. Pozicioni jo i qartë i Beogradit ka lënë shumë serbë të hutuar rreth asaj se a i përkrah apo i kundërshton Beogradi zgjedhjet. Qëndrimet e rradhës të zyrtarëve qeveritarë i kontribuan edhe më tej kësaj hutie. Ata deklaruan se ata të cilët i bashkohen institucioneve të Kosovës dhe punojnë në interes të komunitetit serb do ta kenë përkrahjen e qeverisë serbe. Qëndrimi i paqartë zyrtar i Beogradit i inkurajoi serbët e Kosovës të vendosin të vetëm rreth pjesëmarrjes. Një gazetar serb i Kosovës ka thënë se kur “Beogradi nuk

thotë jo, ai mendon po”. Një analist politik shpjegoi se Beogradi nuk njihet si dikush që heziton ta thotë atë që e mendon. “Beogradi është i paqartë vetëm atëherë kur nuk është i sigurt se çfarë qëndrimi duhet të ketë”.

Së dyti, Beogradi ka vendosur të zvogëlojë fondet e dedikuara për serbët e Kosovës duke reduktuar ndihmën sociale dhe pagat. Ky vendim vjen pas vendimit të Beogradit të vitit të kaluar për suspendimin e administratave komunale “paralele” në komunat me pak apo aspak popullatë serbe. Serbia është prekur rëndë nga kriza e fundit financiare dhe qeveria është duke zvogëluar shpenzimet për të zvogëluar deficitin buxjetor. Beogradi po ashtu është i brengosur se taksapaguesit serbë mund të ngriten kundër subvencionimit të pafund të serbëve të Kosovës, sidomos kur thuhet se fondet e ndara nuk shkojnë te destinacioni i caktuar dhe se po të njëjtat kanë probleme serioze me transparencën gjatë distribuimit.

E treta, gati tri vite pas përkeqësimit të raporteve me Prishtinën, Beogradi është pajtuar për dialog të drejtpërdrejt me institucionet e Kosovës, që pritet të fillojë në pranverë, me sloganin e “bashkëpunimit pa njohje”. Një numër i madh i serbëve të Kosovës thone se tani që Beogradi synon të bisedoj me institucionet e Kosovës, bojkoti i po të njëjtave institucione nga serbët e Kosovës, posaçërisht nga ata që jetojnë në jug, është jopraktik dhe joefikas.

Përkundër këtyre ndryshimeve të mëdha politike, zyrtarët serbë tërheqin vërejtjen se serbët e Kosovës nuk duhet të kenë iluzione se Beogradi do ta përkrah pjesëmarrjen e tyre në institucionet e Kosovës pa arritjen e një marrëveshje të përgjithshme me Prishtinën, gjë që mund të zgjasë për vite ose të mos ndodhë fare, nëse bazohemi në përvojat e kaluara. Disa nga serbët që përkrahin zgjedhjet kanë shpjeguar se ata nuk dyshojnë që Beogradi ka qëllime të mira, por se Beogradi është tepër i kufizuar në mundësitë për të ndihmuar serbët në jug. “Nuk mund të zgjidhësh problemet e një territori të cilin nuk e kontrollon”, ka thënë një serb i jugut.

Disa serbë të Kosovës shkojnë edhe më tej, duke favorizuar vendimmarrjen e pavarur, edhe nëse cmimi për këtë do ishte shkëputja e marrëdhënieve me Beogradin. “Serbët e Kosovës duhet ta marrin fatin në duart e tyre”. Njëri nga bashkëbiseduesit parashikoi se zhvillimet e fundit janë duke shkuar pashmangshëm në atë drejtim. “Beogradi i tha jo zgjedhjeve të vitit 2007, disa serbë votuan; Beogradi i tha jo zgjedhjeve të vitit 2009, më shumë serbë votuan; Beogradi i tha jo zgjedhjeve të vitit 2010, edhe më shumë serbë votuan”. Disa shpjeguan se “propozimet” e Beogradit do të ndiqeshin sikur të ishte sqaruar se çfarë kushte teknike apo politike nuk ekzistojnë dhe për kë, për Beogradin apo për serbët e Kosovën, dhe se si do të mund të krijoheshin këto kushte pa çenuar pavarësinë e Kosovës.

Përfundime dhe rekomandime

Nga këto diskutime kanë dalur disa përfundime dhe rekomandime për ndërmarrje të veprimeve nga ana e serbëve të Kosovës, Beogradit dhe Prishtinës.

- *Të gjitha partitë parlamentare serbe duhet të jenë pjesë e qeverisë:* Të gjitha partitë parlamentare të serbëve të Kosovës duhet ta kenë mundësinë të bëhen pjesë e qeverisë, duke i ndarë dy ministritë e garantuara në proporcion me votat e fituara në zgjedhje. Nëse disa parti parlamentare serbe përjashtohen, do të mbilleshin farërat për konfrontim brendaserb, me

përjashtim të rasteve kur ata vendosin vullnetarisht të mbeten në opozitë. Edhe pse plani i Ahtisaarit dhe kushtetuta e Kosovës garantojnë inkuadrimin automatik të serbëve në qeveri, duke u ndarë atyre dy ministri, të njejtat nuk specifikojnë nëse të gjitha partitë serbe do të duhej të ishin pjesë e qeverisë, ndoshta për shkak se në atë kohë kjo çështje nuk është parashikuar. Por koncepti i proporcionalitetit, i cili aplikohet në alokimin e ulëseve të rezervuara, duhet të të aplikohet edhe në alokimin e pozitave në qeveri.

- *Beogradi duhet të përkrah pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës:* Tani që Beogradi synon të bashkëpunojë drejtpërdrejt me institucionet e Kosovës, bojkotimi i po të njejtave institucione nga serbët e Kosovës, sidomos të atyre në jug, është jopraktik dhe joefikas. Beogradi duhet të vendosë kanale joformale të komunikimit dhe bashkëpunimit me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës. Ky komunikim duhet të fillojë me takime mes anëtarëve serbë në parlamentin e Kosovës dhe anëtarëve të parlamentit të Serbisë si dhe mes përfaqësuesve të partive politike të Serbisë dhe përfaqësuesve të partive politike serbe nga Kosova.
- *Beogradi duhet ta përshtat strategjinë e tij për Kosovën në bazë të gjendjes në terren:* Beogradi duhet të marrë parasysh propozimet politike të serbëve të Kosovës me rastin e formulimit të politikës për Kosovën. Edhe pse nuk e përkrah pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Kosovës, Beogradi më nuk i dënon ata të cilët votojnë, kandidojnë apo që i bashkohen institucioneve. Beogradi po ashtu është pajtuar për fillimin e dialogut të drejtpërdrejt, që pritet të fillojë në pranverë, nën sloganin e “bashkëpunimit pa njohje”. Shumë nga serbët e Kosovës rekomandojnë që Beogradi duhet të ketë një qasje të tillë – integrim pa njohje – karshi inkuadrimit të serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës.
- *Pjesëmarrja në zgjedhje është hap i nevojshëm por jo edhe i mjaftueshëm:* Pjesëmarrja në zgjedhje është thjesht një hap i domosdoshëm por jo edhe i mjaftueshëm për të fituar statusin e dëshiruar për komunitetin serb. Puna më e rëndë dhe më e komplikuar fillon pas zgjedhjeve. Hapat e ardhshëm janë shumë të rëndësishëm kurse përfaqësuesit serbë kanë nevojë për përkrahjen e popullatës serbe, të institucioneve të Kosovës, komunitetit ndërkombëtar dhe Beogradit. Bashkëpunimi mes partive parlamentare serbe konsiderohet kyç në arritjen e qëllimeve të serbëve.
- *Përçarjet përbrenda komunitetit serb duhet të tejkalohen:* Rritja e hendekut mes serbëve në jug dhe atyre në veri do të mund të ketë pasoja të pariparueshme për komunitetin serb. Burim i mosmarrëveshjeve janë vizionet e tyre të kundërta rreth pjesëmarrjes politike. Serbët në jug e mbështesin pjesëmarrjen kurse ata në veri e kundërshtojnë atë. Serbët në jug janë të vetëdijshëm se të ndarë do të kenë sukses të kufizuar në punën e tyre me organet e Kosovës. Një komunitet i bashkuar serb do të rriste fuqinë negociuese të përfaqësuesve serbë në institucione.
- *Të konsolidohen institucionet e komunave serbe dhe të eliminohet dyfishimi institucional në jug të lumit Ibër:* Komunat me shumë serbe janë shumë të vogla që të kenë dy palë institucione lokale. Pjesëmarrja relativisht e lartë e serbëve në zgjedhjet lokale dhe parlamentare tregon për rritjen e vazhdueshme të nivelin të legjitimitetit të institucioneve të zgjedhura lokale dhe rënien e ndikimit të institucioneve paralele. Mirëpo, eliminimi i institucioneve paralele nuk rekomandohet pasi që ato vazhdojnë të luajnë rolin e tyre në dhënien e ndihmës për serbët. Një zgjidhje e mundshme e përkohshme do të ishte zëvendësimi i institucioneve paralele me zyra të cilat do të kishin staf profesional, e jo politik të zgjedhur përmes zgjedhjeve, të cilët do të kishin për detyrë ofrimin e shërbimeve. Është

propozuar poashtu edhe inkuadrimi i përfaqësuesve të institucioneve paralele në institucionet lokale të Kosovës.

- *Partitë dhe zyrtarët shqiptarë duhet ta përkrahin inkuadrimin e pjesëshëm të serbëve:* Prishtina përkrah pjesëmarrjen e serbëve, mirëpo zëra brenda partive politike shqiptare, duke iu frikësuar ndarjes, e kundërshtojnë integrimin e serbëve të jugut përderisa serbët e veriut e përforcojnë sistemin e tyre paralel. Kjo mund të vonojë implementimin e provizioneve të caktuara të planit të Ahtisaarit. Në vend se të pengohet integrimi i serbëve në jug, partitë shqiptare duhet ta përkrahin atë dhe të kërkojnë rrugë për gjetjen e zgjidhjeve për veriun.
- *Të formohet kanali televiziv në gjuhën serbe:* Partitë parlamentare të serbëve të Kosovës duhet që menjëherë ta adresojnë çështjen e kanalit në televizionin publik, të garantuar nga plani i Ahtisaarit. Një kanal publik jo vetëm që do të funksiononte si burim tepër i nevojshëm i informacionit për popullatën e izoluar serbe por gjithashtu do të konsolidonte sektorin e medias së shkapërderdhur të serbëve të Kosovës
- *Të promovohet normalizimi i marrëdhënieve shqiptaro-serbe:* Raportet shqiptaro-serbe janë përmirësuar dukshëm. Shqiptarët e kanë kuptuar se serbët nuk paraqesin kërcënim për pavarësinë e vendit, edhe pse e kundërshtojnë atë, ndërsa serbët e kanë kuptuar se një status i dëshirueshëm për ta mund të gjendet edhe në një Kosovë jashtë kontrollit të Serbisë. Ky status, pikë së pari, do të eliminonte izolimin e tyre nëpër enklava dhe varësinë nga asistencë sociale si nga Beogradi ashtu edhe nga Prishtina. Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të këtyre marrëdhënieve, serbëve të Kosovës duhet t'u ofrohen mundësi punësimi në administratën publike të Kosovës dhe në kompanitë publike, siç janë aeroporti dhe Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës.